



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshor

Kryesia e Kuvendit

P-043

Prishtinë, më 29 tetor 2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Kujtim Paçaku.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Driton Lajçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga KDI: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit me kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, dhe të zëvendëskryeministrit, z. Hashim Thaçi, që Kuvendi i Kosovës më 2 nëntor 2015 ta ratifikojë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Rrepublicës së Kosovës dhe bashkimit evropian.

Lidhur me kërkesën e drejtuesve të Qeverisë së Kosovës diskutuan nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, si dhe nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Kujtim Paçaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet të hënën, më 2 nëntor 2015, në orën 10:00, me këtë pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër

Ndërsa seanca plenare e caktuar më herët për të hënën, më 2 nëntor 2015, me 18 pika të rendit të ditës, shtyhet për ndonjë ditë tjetër.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale